



**REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI**

---

**C.nr.1177/15**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, trupi gjykues në përbërje prej gjyqtarit Arsim Hamzaj - kryetar dhe gjyqtarëve porotë Arife Cukaj dhe Nijazi Elezkurtaj - anëtar, me sekretaren juridike Kujtesa Uka, në çështjen juridike të paditësit B. R., nga Prizreni, kundër të paditurës B. R., e vajzërisë B. në me vendbanim në Austri, tani me adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av.H. K. nga Prizreni, për shkak të zgjidhjes së martesës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën **23.11.2016** mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. ZGJIDHET me shkurorëzim martesë**, e lidhur në mes të paditësit - bashkëshortit B. R., nga Prizreni dhe të paditurës - bashkëshortës B. R., e vajzërisë B. nga Prizreni, e lidhur me ..., pranë zyrës së gjendjes civile në Dragash, e regjistruar me numër rendor ..., dhe me numër të referencës ...

**II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

**A r s y e t i m**

Paditësi B. R., nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës B. B. me vendbanim në Austri, tani me adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av.H. K. nga Prizreni, duke cekur se me të paditurën ka lidhur kurorë me ..., pranë zyrës së gjendjes civile në Dragash. Nga kjo martesë nuk kanë fëmijë të përbashkët. Vetëm 3 muaj pas lidhjes së martesës paditësi ka shkuar në Luksemburg ku ka qëndruar si azilant për 3 vite dhe prej asaj kohe më nuk është kontaktuar me të paditurën. Andaj kjo martesë nuk është e mundur pasi që palët asnjëherë nuk kanë pasur jetë të përbashkët, andaj paditësi i propozon gjykatës që ta zgjidh martesën.

Pasi që e paditura - bashkëshortja jeton në botën e jashtme, gjykata nuk ka mbajtur seancë të pajtimit, konform nenit 76 par.1 pika 2 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK).

Edhe përkundër tentimeve të shumta nga ana e gjykatës për të dërguar ftesën për të paditurën për shqyrtimin kryesor dhe aktvendimin për përgjigje në padi përmes kanaleve diplomatike nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës por ka rezultuar pa sukses, gjykata me

propozimin e palës paditëse të paditurës i'a caktoi përfaqësuesin e përkohëshëm nga radha e avokatëve konform nenit 79.3 të LPK-së.

Edhe gjatë shqyrtimit kryesor paditësi i ka propozuar gjykatës zgjidhjen e martesës, pasi të dy bashkëshortët jetojnë të ndarë, andaj dhe kjo martesë e ka humbur qëllimin e saj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i përkohëshëm i të paditurës av. H. K. nga Prizreni gjatë shqyrtimit kryesor, ka theksuar se nuk ka arritur të kontaktojë me të paditurën e as me familjarët e saj me qëllim që të marrim mendimin e saj në lidhje me padinë e parashtruar për zgjidhjen e kësaj martese, ndërsa në fjalën e fundit ka theksuar se pas administrimit të provave dhe në pamundësi të sigurimit dhe kontaktit me të paditurën nuk janë plotësuar kushtet ligjore për zgjidhjen e kësaj martese andaj propozoj që padia e parashtruar të refuzohet. Shpenzimet procedurës nuk i ka kërkuar sepse është angazhuar nga ana e odës së Avokatëve të Kosovës pa pagesë pro - bono.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata me propozimin e palëve ndërgjyqëse ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat si në vijim: Çertifikatën e martesës me numër rëndor ..., të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Dragash, të datës ...; Dokumenti i udhëtimit të lëshuar nga shteti i Luksemburgut për paditësin B. R. të datës 07.09.2008.

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

**Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.**

Nga çertifikata e martesës me numër rëndor ..., të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Dragash, të datës ... është vërtetuar se paditësi me të paditurën kanë lidhur kurorë pranë zyrës së gjendjes civile në Dragash, më datë ..., e regjistruar me numër rëndor ... dhe me numër të referencës ...

Nga leximi i dokumentit të udhëtimit i lëshuar nga shteti i Luksemburgut, me numër të dosjes R-7011, i lëshuar me datën 07.08.2008, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësi ka qëndruar përkohësisht (si azil-kërkues) në shtetin e Luksemburgut.

Gjykata ka bërë dëgjimin në cilësi të palës për paditësin B. R. nga Prizreni, i cili ka deklaruar “ Se me këtu të paditurën - bashkëshorten ka lidhur kurorë në vitin ... dhe pas kësaj kanë qëndruar bashkërisht në Austri vetëm 3 muaj ku jam larguar për në Luksemburg ku kam qëndruar 3 vite si azilant dhe nga ajo kohë nuk ka kontaktuar me të paditurën. Poashtu thekson se pas kthimit nga Luksemburgu për në Kosovë ka krijuar bashkësi jashtëmartesore nga e cila bashkësi kanë dy fëmijë të përbashkët. Sipas informatave që ka marrë paditësi nga disa të afërm që gjenden në Austri edhe këtu e paditura ka krijuar bashkësi të re në Austri, e cila poashtu ka një vajzë ”.

Sipas nenit 68 par. 1 të LFK-së është e paraparë se “*martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës*”. Me paragrafin 2 të këtij neni parashihet se “*njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke*

*parashtruar padi në gjykatën kompetente. Me nenin 69 të LFK-së, parashihet se “bashkëshorti mund të kërkoj shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht, ose në mënyrë të vazhdueshme, ose për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme. Shkaqet e shkurorëzimit janë mesë tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër të jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e pa arsyeshme, sëmundja psikike e pa shërueshme dhe pa aftësia e vazhduar për të vepruar, **ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit, si dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dy anshme**”.*

Poashtu në dispozitat e nenit 79 par.3 të LPK-së është paraparë se “Gjykata do ti caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste: a) në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë; ....”.

Në bazë të provave të administruara, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për shkurorëzimin e kësaj martese, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësimi i gjykatës për bazueshmërinë e kërkesëpadsisë për shkurorëzim bazohet në dispozitat e nenit 68 dhe 69 të Ligjit për Familjen të Kosovës, pasi që bashkësia martesore në mes të ndërgjyqësve nuk është e mundur, të cilën bashkëshortët e kanë manifestuar edhe me mosinteresimin e tyre që të rivendosin bashkëjetesën martesore, si dhe duke u bazuar në faktin se bashkëshortët pas lidhjes së martesës kanë jetuar të ndarë, të cilin fakt e ka pohuar edhe vet e paditësi, gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Deklarimet e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës se mbesin kontestuese marrëdhëniet bashkëshortore në mes të bashkëshortëve duke propozuar refuzimin e kërkesëpadsisë, gjykata nuk i pranoi duke pasur parasysh faktin se e paditura që nga ndarja nuk ka treguar interesim për vazhdimin e bashkësisë martesore me paditësin. Për rivendosjen e marrëdhënieve bashkëshortore nuk ekzistojnë mundësitë reale, duke pasur parasysh periudhën për të cilën bashkëshortët nuk komunikojnë në mes veti (pothuajse mbi 10 vite) dhe nuk jetojnë bashkë dhe për këtë nuk është e arsyeshme që martesë vetëm formalisht të mbahet, pasi që e njëjta e ka humbur qëllimin dhe efektin e vet, për të cilën është lidhur, e poashtu duke marrë parasysh faktin se këtu paditësi – bashkëshorti ka krijuar edhe bashkësi të re jashtëmartesore. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se martesë duhet të mbahet vetëm kur ekziston dashuria e ndërsjellë e bashkëshortëve, e cila shfaqet në një bashkëjetesë të harmonishme dhe për këtë nuk mjafton vetëm dëshira e njërit bashkëshort, pasi që kushti themelor për lidhjen e martesës është vullneti i palëve - bashkëshortëve, andaj dhe vendosi që ta zgjidhë martesën në mes të bashkëshortëve - palëve ndërgjyqëse.

Përfundimisht gjykata vlerëson se marrëdhëniet në mes të këtu bashkëshortëve janë ç'rregulluar në masë të tillë që nuk ka mundësi për ruajtjen e kësaj martese, pasi që nuk ekziston harmonia bashkëshortore, bashkëjetesa, e sidomos kushti thelbësor i lidhjes-ruajtjes së martesës - vullneti i palëve (bashkëshortëve), andaj dhe vendosi që ta zgjidhë martesën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 449 dhe 452.4 të LPK-së, pasi që pala paditëse nuk i ka kërkuar ato, e poashtu përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës nuk i ka kërkuar shpenzimet pasi që është caktuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, pro - bono.

Nga të lartë cekurat u vendos si më lartë, e konform nenit 143 të LPK-së, në lidhje me nenin 68 dhe 69 të LFK-së.

Bazuar në arsyet e dhëna u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.1177/15, datë: 23.11.2016**

Sekretarja juridike  
Kujtesa Uka

**Kryetari i trupit gjykues**  
**Arsim Hamzaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.